



MARRËVESHJE TEKNIKE
NDËRMJET
QENDRËS KOMBËTARE TË KËRKIM SHPËTIMIT
DHE
ALBCONTROL SHA
MBI
KOORDINIMIN PËR MENAXHIMIN E SHËRBIMIT TË ALARMIT NË
HAPËSIRËN AJRORE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë, 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QKKSH

Nr. 280 Prot, datë 30.06.2023

ALBCONTROL SHA

Nr. 1477 Prot, datë 30.06.2023

**MARRËVESHJE TEKNIKE
NDËRMJET
QENDRËS KOMBËTARE TË KËRKIM SHPËTIMIT
DHE
ALBCONTROL SHA
MBI**

**KOORDINIMIN PËR MENAXHIMIN E SHËRBIMIT TË ALARMIT NË
HAPËSIRËN AJRORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

HYRJE

Qendra e Kërkim – Shpëtimit (referuar në vijim QKKSH) dhe ALBCONTROL SHA (referuar në vijim ALBCONTROL), në kontekstin e përfaqësimit të tyre ligjor dhe institucional në mbështetje të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e shërbimit të alarmit në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, duke njohur nevojën e bashkëpunimit për arritjen e objektivave të tyre në menaxhimin e shërbimit të alarmit në bazë të procedurave në fuqi, nisur nga nevoja për lehtësimin e procedurave të përbashkëta të koordinimit dhe bashkëpunimit në menaxhimin e shërbimit të alarmit dhe domosdoshmërisë së interpretimit të njëjtë të këtyre procedurave, duke menduar se një Marrëveshje Teknike do të ndihmojë në zgjidhjen e situatave operationale të përbashkëta në mënyrën më efektive të mundshme dhe duke mbajtur parasysh referencat e mëposhtme ligjore:

1. ICAO Dokument 4444 ATM/501 “Procedurat për SH.T.A”;
2. ICAO Aneks 2 “Rregullat e Ajrit”;
3. ICAO Aneks 11 “Shërbimet e Trafikut Ajror”;



4. ICAO Aneks 12 “Kërkim shpëtimi”;
5. Ligji nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”;
6. Urdhri i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 193, datë 06.10.2022 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre”;
7. Ligji nr. 10435, datë 23.06.2011 “Për Shërbimin e Kërkim-Shpëtimit në RSH”;
8. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 742, datë 16.10.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit”;
9. Manuali i Operimit të Shërbimeve të Trafikut Ajror shqiptar,

bien dakord si më poshtë vijon:

1. TË PËRGJITHSHME

1.1 Qëllimi

Qëllimi i Marrëveshjes Teknike është të përcaktojë procedurat e koordinimit dhe bashkëpunimit në menaxhimin e shërbimit të alarmit në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë midis Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit (QKKSH) dhe ALBCONTROL SHA, procedura të cilat janë bazuar në standardet e ICAO-s dhe në legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Koordinimi ndërmjet QKKSH dhe ALBCONTROL respekton dallimet në procedurat dhe veprimet operationale e institucionale të palëve nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje.

1.2. Statusi Operacional

Të dyja palët janë të detyruara të koordinojnë ndërmjet tyre për çdo ndryshim të statusit operacional apo të mjeteve të tyre të operimit, të cilat ndikojnë në procedurat e specifikuar në këtë Marrëveshje Teknike.

2. ZONAT E INTERESIT DHE PËRGJEGJËSIVE PËR DHËNIEN E SHËRBIMEVE RESPEKTIVE

Zonat respektive janë specifikuar në Aneksin B të kësaj marrëveshjeje.

2.1. Zona e Përgjegjësisë së ALBCONTROL Tirana Area & Approach Control Center (ACC/APP):

Tirana ACC/APP



Njësia Tirana ACC është përgjegjëse për dhënien e shërbimit të kontrollit të trafikut ajror, shërbimit të informacionit si dhe të alarmit në zonën e saj të përgjegjësisë në nivelin FL 115 dhe më sipër në gjithë hapësirën ajrore Tirana FIR, përjashtuar zonën e përgjegjësisë së Tirana APP.

Njësia Tirana APP ofron shërbimin e kontrollit të trafikut ajror, shërbimin e informacionit dhe të alarmit në zonën e TMA (klasë C) nga nivelet Altitude 2500 ft AMSL deri në FL 195 dhe në gjithë FIR-in e Shqipërisë nën nivelin FL 115 në hapësirë të pakontrolluar (në klasën G).

2.2 Tirana TWR: Kulla e Kontrollit të Aerodromit “Nënë Tereza”

Kulla e Kontrollit të Aerodromit “Nënë Tereza” ofron shërbimin e kontrollit të trafikut ajror, shërbimin e informimit dhe të alarmit në zonën e saj të përgjegjësisë Tirana CTR (klasë D), nga niveli i tokës deri në Altitude 2500 ft. Koordinatat e Tirana CTR jepen në “Aneksin B”.

2.3 Kukës FIZ/RMZ

“Kukës information” ofron informacion mbi fluturimet dhe shërbimin e alarmit brenda zonës së tij të përgjegjësisë (klasë G) nga GND deri në FL 115.

Koordinatat gjeografike të Kukës FIZ/RMZ janë:

415929N 0203631E - 415901N 0194718E - 422301N 0194651E - 422314N 0201342E

Ndërsa, Aeroporti i Kukësit ndodhet në këto koordinata: 420208N 0202457E.

2.4 Përgjegjësitë e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit

QKSSH është strukturë përgjegjëse për planizimin, organizimin, koordinimin dhe kryerjen e operacioneve të kërkim – shpëtimit në hapësirën tokësore, detare e në ujërat territoriale dhe përkatësisht në hapësirën Tirana FIR të Republikës së Shqipërisë, si dhe në zonat e përgjegjësisë, të ndara sipas marrëveshjeve dy ose shumë palëshe të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë.

QKSSH:

- Lokalizon mjetet ajrore dhe personat në bordin e tyre, që janë në rrezik dhe/ose të aksidentuar në rajonin e kërkim-shpëtimit të Republikës së Shqipërisë dhe drejton për në vendin e aksidentuar, sa më shpejt të jetë e mundur, njësitë e nevojshme të shpëtimit;



- Siguron ndihmë për mjetet ajrore dhe për personat në rrezik në bordin e tyre në zonën e përgjegjësisë, në përputhje me mundësitë reale;
- Koordinon operacionet e kërkim – shpëtimit për mjetet fluturuese, të cilat mund të kërkohen mbështetjen e Qendrës Kombëtare për Kërkim dhe Shpëtim;
- Ndihmon operacionet e kërkim - shpëtimit për avionët ushtarakë patrullues të NATO-s¹.

3. PROCEDURAT

Procedurat që do të zbatohen nga QKKSH dhe ALBCONTROL për koordinimin dhe menaxhimin e shërbimit të alarmit në hapësirën ajrore të RSH janë të detajuara në Aneksat e mëposhtme:

- Përkufizime dhe shkurtime (Aneksi A),
- Organizimi i Hapësirës (Aneksi B),
- Procedurat operacionale dhe koordinimi (Aneksi C),
- Procedurat e komunikimit për shkëmbimin e informacionit meteorologjik (Aneksi D),
- Faturimet mujore si dhe transferimi i fondit të destinuar për SAR nga tarifat navigacionale të ALBCONTROL (Aneksi E).

4. RISHIKIMI DHE DEVIJIMET

4.1 Rishikimi i Marrëveshjes Teknike

Rishikimi i Marrëveshjes Teknike dhe anekseve, kërkon miratimin e dyanshëm me shkrim të autoriteteve nënshkruese.

4.2 Devijimet e përkohshme

Kur është e nevojshme, drejtuesit e strukturave respektive mund të iniciojnë me marrëveshje të përbashkët dhe për një periudhë të caktuar kohore, modifikime të përkohshme të procedurave të vendosura në anekset e kësaj marrëveshje.

¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 274, datë 13.4.2016 “Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE), për patrullimin e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë”, pika C 5.10 Operacionet e kërkim-shpëtimit (SAR).



4.3 Devijimet në raste të veçanta

Në raste të veçanta mund të jetë i nevojshëm devijimi nga procedurat e përcaktuara në anekset e kësaj marrëveshje teknike. Në këto rrethana, mbikëqyrësit e turneve dhe /ose drejtuesit e qendrave respektive mund të përdorin gjykimin e tyre për të ruajtur sigurinë në fluturim dhe efikasitetin e trafikut ajror. Në çdo rast, pala që do të kryejë devijimin, do të njoftojë, brenda një afati të arsyeshëm palën tjetër.

5. ZGJIDHJA

Zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje Teknike mund të bëhet në çdo kohë dhe për këtë qëllim secila palë duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim të paktën 3 muaj më parë.

6. INTERPRETIMI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin si pasojë e interpretimeve të ndryshme apo zbatimit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Teknike, palët duhet të përpiqen të gjejnë një zgjidhje të pranueshme ndërmjet tyre. Në rast se zgjidhja nuk arrihet, secila palë duhet t'i drejtohet instancës së saj më të lartë, në të cilën mosmarrëveshja duhet të adresohet për zgjidhje.

7. VLEFSHMËRIA

Kjo Marrëveshje Teknike hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe zbatimi i saj fillon në datë 03.07.2023.

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje origjinale me vlerë të njëjtë ligjore, nga të cilat 2 (dy) për QKKSJ dhe 2 (dy) për ALBCONTROL.

Marrëveshja Teknike me nr. prot. 173, datë 23.09.2019 për QKKSJ dhe nr. prot. 2090/1, datë 23.09.2019 për ALBCONTROL, shfuqizohet.

PËR

QENDRËN KOMBËTARE
TË KËRKIM SHPËTIMIT

KRYETAR

Kolonel Fiqiri Hoxha



PËR

ALBCONTROL SHA

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Laureta Omeri



Efektive nga: 03/07/2023

Marrëveshje Teknike



ANEKSI - A

PËRKUFIZIME DHE SHKURTIME

Tirana ACC: Area Control Center

Njësi e përcaktuar për të siguruar shërbimin e kontrollit të trafikut ajror për të gjithë FIR-in Shqiptar. Kontrollon fluturimet në zonën e kontrollit brenda sektorit të saj të përgjegjësisë.

Tirana APP: Approach Control

Njësi e përcaktuar për të siguruar shërbimin e kontrollit të trafikut ajror në zonën terminale dhe në zonat që mund t'i delegojë ACC. Kontrollon fluturimet e mjeteve ajrore që ulen apo ngrihen nga një apo më shumë aerodrome civile.

Tirana TWR: Kulla e Kontrollit të Aerodromit "Nënë Tereza"

Njësi e përcaktuar për të siguruar shërbimin e kontrollit të trafikut ajror për trafikun brenda CTR (IFR dhe VFR) në aerodromin "Nënë Tereza"

Altitude

Distanca vertikale e një lartësie, një pike apo një objekti i konsideruar si një pikë e matur nga niveli i detit.

Zonë Kontrolli CTA

Hapësira e kontrolluar e shtrirë në lartësi nga sipërfaqja e tokës deri në një limit të kufizuar të sipërm.

Faza e emergjencës

Një term i përgjithshëm që ka kuptimin sipas rastit dhe përmbledh:

Fazën e Paqartësisë, Fazën e Alarmit dhe Fazën e Rrezikut.

Faza e Paqartësisë: INCERFA

Është një fazë kur ekziston paqartësia për sigurinë e një mjeti ajror dhe të pasagjerëve të tij.

Faza e Alarmit: ALERFA

Është një fazë kur ekziston frika për sigurinë e një mjeti ajror dhe për pasagjerët e tij.



Faza e Rrezikut: DETRESFA

Është një situatë ku është shumë e qartë që një mjet ajror dhe pasagjerët e tij janë të kërcënuar nga një rrezik i madh e i qartë dhe që kërkon një ndihmë të menjëhershme.

FIR - Rajoni i informacionit i fluturimit: Hapësira ajrore mbi kufijtë tokësorë dhe detarë të përcaktuar në marrëveshje ndërkombëtare dhe ato rajonale të navigimit ajror në të cilën kryhen shërbimet e trafikut ajror.

Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit: Nënkupton strukturat, sistemet e vrojtimit, personelin dhe mjetet për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.

Shkurtime dhe shpjegime

ALBCONTROL	Ofruesi Kombëtar i SHTA
QKKSH	Qendra Kombëtare e Kërkim - Shpëtimit
KTA	Kontrolli i Trafikut Ajror
ACC	Qendra e Kontrollit të Zonës
APP	Njësia e Kontrollit të Afrimit
ATS	Shërbimi i Trafikut Ajror
CTR	Zona e Kontrollit
TMA	Zona Terminale
TWR	Kulla e Kontrollit
FIR	Rajoni i Informacionit të Fluturimit
VFR	Rregullat e Fluturimit Vizual
INO	Zyra e Notameve Ndërkombëtare
AFTN	Rrjeti Fiks i Telekomunikimve Aeronautike



ANEKSI – B
ORGANIZIMI I HAPËSIRËS
B.1 SEKTORIZIMI I KTA

Sektorët e KTA	Limitet Vertikale dhe Horizontale	Njësia që Siguron Shërbimin	Shenja e Thirrjes në Frekuencë	Klasifikim i hapësirës
TWR	Ground/2500ft CTR	Tirana TWR	Tirana TWR 122.5	Class D
APP Sector	2500ft/FL 195 TMA	Tirana ACC/APP	Tirana APP 133.150	Class C
Middle Sector	FL 110/FL 335 FIR	Tirana ACC	Tirana Radar 127.500	Class C
Upper Sector	FL 335/FL 365 FIR	Tirana ACC	Tirana Radar 134.275	Class C
Top Sector	FL 365/FL 660 FIR	Tirana ACC	Tirana Radar 131.075	Class C
Kukës AFIS	GND-FL 115 Kukës FIZ/RMZ	Kukës Information	Kukës Information 118.375	Class G

B1.1 Koordinatat e CTR

Emri dhe kordinantat	Kufijtë vertikal	Klas i i habs irës	Njësia ATS callsign/ gjuha	Transition Altitude	Hours of applicability	Shënim e
1	2	3	4	5	6	7
Tirana CTR 411000N 0195000E 411000N 0193100E 414000N 0193100E 414000N 0195000E	Upper limit: 2500 FT AMSL Lower limit: GND Lower limit: GND	D	Tirana Tower EN	10000 FT	H24	NIL



B1.2 Koordinatat e Kukës FIZ/RMZ

Emri dhe kordinantat	Kufijtë vertikal	Klasi i hapsirës	Njësia ATS callsign/ gjuha	Transition Altitude	Hours of applicability	Shënime
1	2	3	4	5	6	7
Kukës FIZ/RMZ 415929N 0203631E - 415901N 0194718E - 422301N 0194651E - 422314N 0201342E	Upper limit: FL 115 Lower limit: GND	G	Kukës Aerodrome Information EN	10000 FT	Applicable during AFIS unit operational hours	Outside AFIS HO, pilots entering Kukës FIZ/RMZ are requested to contact Tirana APP on frequency 133.150Mhz to recive flight information

Pikat raportuese të Tirana CTR për fluturimet VFR

Emri	Zona	Koordinatat	Shënime
ERZED*	Kryqëzimi i Lumenjve Stermas	411543N 0195027E	Pikë e përdorshme vetëm për mjetet e FAj.
BRARI	Ura Ferraj	412220N 0195118E	
LORJA	Ura e Fanit	414215N 0194626E	
MIMCO	Kepi i Rodonit	413415N 0193100E	
ROBZO	Mali i Robit	411354N 0193133E	
ZAZMA	Fshati Roshet	410944N 0194404E	

Pikat tranzite për fluturimet VFR

Emri	Zona	Koordinatat	Shënime
MATIA	Rezervuari Marikaj	412237N 0193823E	Përdoren për qëllime operacionale si



			rreth rrotullim, transitim të CTR apo pistës në përdorim.
TUFIZ	Rezervuari Qinamit	412433N 0194752E	

B.2 Zonat e Ndaluar (Prohibited)/Kufizuara (Restricted)/Rrezikshme (Danger)

B.2.1. Zonat e Ndaluar (Prohibited Areas):

Nuk ka

B.2.2. Zonat e Kufizuara (Restricted Areas):

Kodi (Përshkrimi/Statusi)	Kufiri Gjatësor (WGS 84)	Kufiri Vertikal <u>Upper Limit</u> Lower Limit	1. Lloji i Aktivitetit 2. Kufizimet 3. Shënime
LAR1 KUÇOVA	Një rreth me rreze 3 milje nga pika referuese: 404619N 0195407E	<u>2500 FT AMSL</u> GND	1. Zonë ushtarake. 2. E ndaluar për fluturimet GAT. Kalimi i GAT lejohet vetëm me PPR (Kërkesë Paraprake për Leje) të paktën 24 orë përpara miratuar nga QKR dhe Tirana ACC.
LAR2 GJADRI	Një rreth me rreze 3 milje nga pika referuese: 415337N 0193558E	<u>2500 FT AMSL</u> GND	1. Zonë ushtarake. 2. E ndaluar për fluturimet GAT. Kalimi lejohet vetëm me PPR (Kërkesë Paraprake për Leje) të paktën 24 orë përpara miratuar nga QKR dhe Tirana ACC.



<p>LAR3A FARKA Helidromi Farkë (Mil)</p>	<p>411851N 0195121E 412200N 0195300E 412200N 0200000E 411200N 0200000E 411200N 0195651E 411401N 0195530E 411734N 0195119E 411851N 0195121E</p>	<p><u>5500 FT AMSL</u> GND</p>	<p>1. Zonë ushtarake.</p> <p>2. Kalimi i GAT lejohet vetëm me PPR (Kërkesë Paraprake për Leje) të paktën 24 orë përpara miratuar nga QKR dhe Tirana ACC.</p> <p>Tel/Fax: +355 44504700 (civil) 5131045/1078 (Mil)</p> <p>Email: gkrfaj@aaf.mil.al</p> <p>3 Çdo fluturim i mjeteve të forcës ajrore duhet të vendosë/mbajë kontakt me radio me Kullën "Farka TWR", gjatë hyrjes/kalimit/daljes nga zona e heliodromit Farkë.</p> <p>Frekuenca primare e punës: Farka TWR 128.00 MHz.</p> <p>4. Çdo fluturim i mjeteve ajrore GAT do të udhëzohen të fluturojnë jashtë zonave të kufizuara të Farkës. Në rast emergjencash apo pamundësie të fluturimit, kalimi i zonës së kufizuara do të bëhet me koordinim mes Kullës Farkë dhe njësisve të trafikut ajror.</p>
---	--	------------------------------------	---



LAR4 KOPLIKU	421116N 0191726E 421425N 0192100E 421438N 0192108E 421228N 0192236E 421154N 0192053E 421129N 0191858E 421116N 0191726E	<u>3500 FT AMSL</u> GND	<ol style="list-style-type: none">Zonë e mbrojtur për procedurat e uljes me pistë 36 në Aeroportin e Podgoricës.Hyrja ose kalimi i kësaj zone është subjekt i koordinimit paraprak me Tirana APP
---------------------	--	----------------------------	---

B.2.3. Zonat e Rrezikshme (Danger Areas):

Kodi (Përshkrimi/Statusi)	Kufiri Gjatësor (WGS 84)	Kufiri Vertikal <u>Upper</u> <u>Limit</u> Lower Limit	1. Lloji i Aktivitetit 2. Shënime
LAD1 RRETH GRETHI	410937N 0192032E - 410656N 0192737E - 410517N 0193000E - 405800N 0193000E - 405700N 0190600E - 410900N 0190600E - 410937N 0192032E	<u>FL 285</u> <u>AMSL</u> GND <u>5500 FT</u> <u>AMSL</u> GND	<ol style="list-style-type: none">Zonë AMC ManageableQitje me të gjitha llojet e armëve.Për aktivizimin, do të njoftohet nëpërmjet AUP/UUP si dhe NOTAM të paktën 24 orë përpara fillimit të aktivitetit <p>* Zonë stërvitje me limit vertikal deri në 5500 ft</p>
LAD2 BIZA	412324N 0201048E - 412100N 0201424E - 411824N 0201048E - 412100N 0200824E - 412324N 0201048E	<u>FL 150</u> GND	<ol style="list-style-type: none">Zonë AMC ManageableQitje me të gjitha llojet e armëvePër aktivizimin, do të njoftohet nëpërmjet AUP/UUP si dhe



			NOTAM të paktën 24 orë përpara fillimit të aktivitetit.
--	--	--	---

B.3 Zona speciale për zhvillimin e stërvitjeve të Forcës Ajrore & zona të rezervuara të përkohshme (TRA/TSA)

Kodi (Përshkrimi/Statusi)	Kufiri Gjatësor (WGS 84)	Kufiri Vertikal Upper Limit Lower Limit	1. Lloji i Aktivitetit 2. Kufizimet 3. Shënime
LATRA1A KUÇOVA	410600N 0200900E 405150N 0200825E 405151N 0192301E 405535N 0191920E 410600N 0200900E	<u>2500 FT AMSL</u> GND	1. Zona AMC Manageable 2. Zona stërvitjeje që do të aktivizohet me NOTAM të paktën 24 orë përpara fillimit të aktivitetit.
LATRA1B KUÇOVA	405535N 0191920E 405151N 0192301E 405153N 0193454E 403600N 0193500E 404600N 0191200E 405400N 0191200E 405535N 0191920E	<u>10000 FT AMSL</u> GND	3. E ndaluar për fluturimet GAT kur zona është deklaruar aktive. 4. Nëse për arsye specifike do të kërkohen ndryshime vertikale, ato do të bëhen në bazë taktike ndërmjet QKR dhe Tirana APP. 5. Në kordinim taktik zonat do të modulohen duke konsideruar edhe fluturimet GAT.
LATRA1C KUÇOVA	403600N 0193500E 405153N 0193454E 405150N 0200825E 404200N 0200800E 403600N 0193500E	<u>10000 FT AMSL</u> GND	
LATRA2B GJADRI	415851N 0193141E 415913N 0200732E 414504N 0200730E 414500N 0193147E	<u>2500 FT AMSL</u> GND	1. Zonë AMC Manageable 2. Zonë stërvitjeje që do të aktivizohet me NOTAM të paktën 24 orë përpara fillimit të aktivitetit.



	415851N 0193141E		<p>3. E ndaluar për fluturimet GAT kur zona është deklaruar aktive.</p> <p>4. Nëse për arsye specifike do të kërkohen ndryshime vertikale, ato do të bëhen në bazë taktike.</p>
LATSA1	401951N 0203701E 403451N 0205506E 410613N 0202934E 404953N 0201055E 401951N 0203701E	<u>FL 285</u> FL 120	<p>1. Zonë AMC Manageable</p> <p>2. Zonë stërvitjeje që do të aktivizohet me NOTAM të paktën 24 orë përpara.</p> <p>3. E ndaluar për fluturimet GAT kur zona është deklaruar aktive, përveç avionëve në emergjencë.</p> <p>4. Kalimi i TSA-së do të behet me leje në pikat NATTO dhe TIRVU.</p>



Figura 1: Zonat stërvitore ushtarake







Figura 2 : Zonat e Kufizuara dhe të Rrezikshme





ANEKSI – C

PROCEDURAT OPERACIONALE DHE KOORDINIMI GJATË SHËRBIMIT TË ALARMIT DHE KËRKIM SHPËTIMIT

QKKSJ dhe ALBCONTROL koordinojnë veprimet midis tyre gjatë fazave të shërbimit të alarmit dhe gjatë kryerjes së operacioneve të kërkim-shpëtimit, në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar dhe kombëtar të referuar më sipër.

C.1 Të përgjithshme

ALBCONTROL nëpërmjet Tirana ACC do të shërbejë si pikë qendrore për mbledhjen e informacionit të vlefshëm për një avion në emergjencë brenda FIR të Shqipërisë dhe është i detyruar t'ia japë menjëherë këtë informacion Qendrës Kombëtare të Kërkim Shpëtimit.

C.2 Kordinimi sipas fazave të alarmit dhe emergjencës

C.2.1 Faza e Paqartësisë (INCERFA)

ACC e Tiranës do të lajmërojë Qendrën Kombëtare të Kërkim Shpëtimit menjëherë sapo avioni është konsideruar prej saj që është në Fazën e Paqartësisë kur:

- a) Asnjë komunikim nuk është marrë nga një avion brenda një periudhe prej 30 minutash prej kohës në të cilën ky komunikim duhej të ishte bërë, ose kur,
- b) një avion dështon të arrijë brenda një periudhe prej 30 minutash nga koha e parashikuar për ardhje, e lajmëruar prej tij apo e parashikuar nga njësi e trafikut ajror, cilado qoftë më e mëvonshme, përveç rastit kur nuk ka asnjë dyshim për sigurinë e avionit apo të pasagjerëve të tij.

Pas njoftimit të marrë nga ACC e Tiranës, gjatë Fazës së Paqartësisë, Qendra e Kombëtare e Kërkim Shpëtimit do të bashkëveprojë në maksimum me Njësinë e Trafikut Ajror dhe agjensitë apo shërbimet e tjera në mënyrë që raportet që vijnë të vlerësohen sa më shpejt.

C.2.2 Faza e Alarmit (ALERFA)

ACC e Tiranës do të lajmërojë Qendrën Kombëtare të Kërkim Shpëtimit menjëherë sapo avioni është konsideruar prej saj që është në Fazën e Alarmit kur:

- a) Në vazhdim të Fazës së Paqartësisë, përpjekje të vazhdueshme për të stabilizuar kontaktin me avionin apo kërkimet nëpërmjet burimeve të tjera kanë dështuar të nxjerrin ndonjë të dhënë të re për të, ose kur,
- b) Një avion është lejuar për t'u ulur dhe ai dështon të ulet brenda 5 minutash nga koha e parashikuar për ulje dhe komunikimi me të nuk është stabilizuar, ose kur,



c) Informacioni që është marrë, tregon që efienca operationale e një avioni është përkeqësuar, por jo në atë gradë që të kryejë një ulje të detyruar, përveç rastit kur ka fakte që siguria e avionit dhe pasagjerëve është në rrezik, ose kur,

d) Një avion është apo dyshohet që është subjekt i një ndërhyrje të jashtëligjshme.

Pas njoftimit të marrë nga ACC e Tiranës, gjatë Fazës së Alarmit, Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit do të njoftojë menjëherë Njësitë e Kërkim Shpëtimit dhe do të fillojë veprimet e nevojshme sipas skemës së miratuar.

C.2.3 Faza e Rrezikut (DETRESFA)

ACC e Tiranës do të lajmërojë Qendrën Kombëtare të Kërkim Shpëtimit menjëherë sapo avioni është konsideruar prej saj që është në Fazën e Rrezikut kur:

a) Në vazhdim të Fazës së Alarmit, përpjekje të mëtejshme të pasuksesshme për të stabilizuar komunikimin dhe kërkimet e mëtejshme të pasuksesshme çojnë në përfundimin që ky avion është në rrezik, ose kur,

b) Karburanti në bordin e avionit konsiderohet në përfundim, ose është i pamjaftueshëm për të arritur në destinacion, ose kur,

c) Informacioni i marrë tregon që efienca operationale e një avioni është përkeqësuar në atë shkallë sa që mund të ndodhë një ulje e detyruar, ose kur,

d) Informacioni është marrë ose është plotësisht e sigurtë që avioni po bën apo ka bërë një ulje të detyruar.

Pas njoftimit të marrë nga ACC e Tiranës, gjatë Fazës së Rrezikut, Qendra Kombëtare e Kërkim- Shpëtimit do të veprojë sipas procedurës së brendshme të miratuar.

C.3 Kërkesat për komunikim

QKKSJ duhet të ketë mjete komunikimi të dyanshëm me njësitë e shërbimeve të trafikut ajror në ALBCONTROL.

C.4 Mënyra e shkëmbimit të informacionit

Mbikëqyrësi i Tirana ACC do të njoftojë Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit sipas këtij rendi:

- 1) INCERFA/ALERFA/DETRESFA sipas fazave të emergjencës;
- 2) Emri i njësisë së kontrollit ajror si dhe emri i personit që e dërgon këtë mesazh;
- 3) Natyra e Emergjencës;
- 4) Informacioni thelbësor nga plani i fluturimit të avionit;



- 5) Njësia e trafikut që e ka patur për herë të fundit në kontakt, ora dhe mjetet e përdorura;
- 6) Pozicioni i fundit i raportuar dhe si është përcaktuar;
- 7) Mallrat e rrezikshme (nëse ka);
- 8) Ngjyra dhe shenjat dalluese të avionit;
- 9) Veprimet e bëra nga njësia e trafikut ajror;
- 10) Informacione të tjera të vlefshme.

Gjithashtu Tirana ACC do t'i japë këto informacione shtesë Qendrës Kombëtare të Kërkimit Shpëtimit:

- i) Informacion shtesë për zhvillimin e situatës së emergjencës sipas fazave përkatëse;
- ii) Informacion për një emergjencë nga burime të tjera si AFTN, Qendrat fqinje, raportim piloti etj;
- iii) Informacion kur situata emergjente nuk ekziston më.

Informacioni i dhënë nga Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit tek Tirana ACC:

- a) Njofton ACC e Tiranës, kur informacioni për një avion në emergjencë është marrë nga burime të tjera;
- b) Kur është e mundur, QKKSH do të njoftojë ACC e Tiranës që të informojë avionin që është në emergjencë, që veprimet e kërkim shpëtimit kanë filluar;
- c) Të kërkojë nga ACC e Tiranës, nëse avionët e tjerë mund të ndihmojnë në përcaktimin e pozicionit të avionit në emergjencë;
- d) Të kërkojë nga ACC e Tiranës largimin e avionëve të tjerë, pasi kanë filluar veprimet e kërkim shpëtimit;
- e) Të kërkojë informacione shtesë nga ACC e Tiranës dhe ajo të përgjigjet sipas mundësive;
- f) Të informojë ACC e Tiranës kur veprimet e kërkim shpëtimit janë konsideruar të mbyllura.

C. 5 Frekuencat dhe pikat e kontaktit



Frekuenca dhe pikat e kontaktit në Qendrën e Kombëtare të Kërkim Shpëtimit (QKKSH):

VHF 121.5 Mhz	Frekuenca Kryesore në Monitorim
UHF 243.0 Mhz	Frekuenca Alternative në Monitorim
+355 4 224 0081	Personeli i shërbimit SAR QKKSH
+355 4 222 6601/02 – 1021	Linja ushtarake SAR “QKKSH”
+355 68 804 6638	Koordinatori i Kërkim-Shpëtimit SAR Detar/Ajror (QKKSH)

Frekuencat dhe pikat e kontaktit në ACC (ALBCONTROL):

VHF 122.5	Frekuenca e Kullës
VHF 127.5	Frekuenca e ACC
VHF 133.15	Frekuenca e Afrimit
VHF 118.375	Frekuencat e Kukës Information
VHF 121.5	Frekuenca e emergjencës
+355 4 234 3487	AFTN/numri i brendshëm
+355 4 237 1230	ACC/numri i brendshëm – Mbikqyrësi i ACC
513 – 1038	Linja ushtarake koordinatori ushtarak pranë ACC (ALBCONTROL)

C.6. Shërbimi SAR në lidhje me incidentet në Aeroportin Nënë Tereza

C.6.1 Në rast të një incidenti brenda zonës së aeroportit, koordinimi dhe kontrolli operacional i incidentit ndërmerren nga autoritetet e aeroportit, të cilat mund të kërkojnë ndihmën e QKKSH, nëse konsiderohet e nevojshme.

C.6.2 Në rast të një incidenti jashtë zonës së aeroportit deri në një distancë prej 5NM / 8 Km nga qendra e pistës, koordinimi dhe kontrolli operacional i incidentit kryhet nga QKKSH, ndërsa autoritetet e aeroportit mund të kontribuojnë për të mbështetur me personat e tyre të vënë në dispozicion.

C.6.3 Në rast të një incidenti brenda aeroporteve dhe objekteve ushtarake, koordinimi dhe kontrolli operacional i incidentit kryhet nga Qendra Kombëtare Ajrore e Kërkim Shpëtimit (KAKSH). Në të gjitha fushat e tjera koordinimi dhe kontrolli operacional ndërmerret nga QKKSH.



ANEKSI - D

PROCEDURAT E KOMUNIKIMIT PËR SHKËMBIMIN E INFOMACIONIT METEOROLOGJIK

Në mënyrë që të garantohet shërbimi i informacionit meteorologjik për Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, komunikimi ndërmjet Sektorit MET të ALBCONTROL duhet të funksionojë si më poshtë:

1. Kur Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit kërkon informacion meteorologjik të lidhur me aktivitetet e tyre, do të kontaktojë me telefon parashikuesin (forecaster) në detyrë të sektorit MET pranë ALBCONTROL (informacion meteorologjik vetëm për zonën e aeroportit).
2. Parashikuesi në detyrë do të dërgojë Met-report dhe parashikimin për zonën e kërkuar dhe periudhën e kohës nëpërmjet komunikimit telefonik.
3. Në përputhje me dispozitat e ICAO Annex 3, Met-report duhet të përmbajë:
 - a) Fenomenet sinjifikativë të motit (nëpërmjet mesazheve SIGMET dhe AIRMET);
 - b) Sasinë e reve dhe tipin e tyre, veçanërisht “cumulonimbus”, treguesit e lartësisë së bazës dhe majës;
 - c) Shikueshmërinë dhe fenomenet që e zvogëlojnë atë;
 - d) Erën në sipërfaqe për zonën e aerodromit dhe parashikimin për erën në nivele të larta të kërkuara (nga ground deri në FL 100);
 - e) Presionin në nivelin e detit - QNH
4. Në marrëveshje me QKKSH gjendja në det dhe temperatura e sipërfaqes së detit nuk do të përfshihet në raport.
5. Raporti meteorologjik duhet të shkruhet në shqip dhe njësitë matëse të mëposhtme duhet të përdoren:
 - a) Sasia e reve “në të tetat” të kupës qiellore;
 - b) Baza dhe maja e reve në “feet”;
 - c) Shikueshmëria në “metra dhe kilometra”;
 - d) Presioni atmosferik në “hektopascal”.
6. Në rast ndryshimesh të mëtejshme të raportit meteorologjik ose për çdo arsye tjetër, parashikuesi në turn duhet të përdorë numrat operacionalë të telefonit për të informuar QKKSH.
7. Mënyra e komunikimit midis Sektorit MET dhe QKKSH.
Sektori i Parashikimit pranë SHMU
Telefon: 0035544504204; e-mail: sherbimimeteorologjik@gmail.com
Sektori MET pranë ALBCONTROL
Telefon: 0035544522152; e-mail: sinoptika@albcontrol.al



ANEKSI – E

FATURIMET MUJORE DHE TRANSFERIMI I FONDIT TË DESTINUAR PËR SAR NGA TARIFAT NAVIGACIONALE TË ALBCONTROL

• E.1. Të përgjithshme

Transferimi i fondit të destinuar për SAR-in nga tarifat navigacionale të ALBCONTROL bëhet çdo muaj në llogarinë e QKKSH-së.

Ky fond përcaktohet mbi bazën e kërkesave të Rregullores së Eurocontrol “Parimet për përcaktimin e kostos bazë për pagesat gjatë udhëtimeve në korridoret ajrore dhe për llogaritjen e tarifës së njësisë”.

Kostot e përfshira në këto kategori janë ato për shërbimin e “kërkim shpëtimit”, që i ofrohen shërbimit të Aviacionit Civil sipas kriterëve të mëposhtme:

- do të merren parasysh vetëm objektet aeronautike dhe shërbimet e përfshira në Planin Navigacional Ajror rajonal të ICAO-s,
- caktimi i kostove do të bëhet në një mënyrë të tillë që të sigurojë se asnjë përdorues i hapësirës ajrore nuk do të paguajë për kostot që nuk i takojnë,
- këto operacione do të kryhen me saktësinë e transparencën e duhur dhe përdoruesit e hapësirës ajrore do të furnizohen me informacionin e duhur, në veçanti, lidhur me kostot e objekteve dhe shërbimet e ofruara,
- shtetet do t’ju japin përdoruesve të hapësirës ajrore informacionin e nevojshëm mbi mekanizmin e pagesës siç është përcaktuar në Shtojcën II dhe III të Rregullores së Eurocontrol.

E.2. Detyrimet e palëve

Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit çdo vit, brenda datës 10 Maj, harton listën e inventarit/vlerave të amortizimit të pajisjeve/aseteve në përdorim nga shërbimi SAR, të dedikuara për operimet ajrore dhe ja dërgon ALBCONTROL.

ALBCONTROL verifikon dhe konfirmon listën e aseteve të dërguar nga QKKSH, e cila miratohet më pas në EUROCONTROL.

ALBCONTROL, pas ardhjes së faturave mujore të hartuara nga QKKSH, derdh çdo muaj në llogarinë e QKKSH fondet për kërkim-shpëtimit, të krijuar në ALBCONTROL si rezultat i kërkesave të Eurocontrol.

